Numër: 01-976 Datë: 13.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026 merr:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Instituti Profesional Sh.P.K. "ATC", me adresë në Rr. "UÇK" Nr. 62, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare (07.10.2026 - 06.10.2029), për zbatimin e procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) për kualifikimet përkatëse sipas niveleve dhe llojit të tyre në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

2. **Bërës ëmbëlsirash** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 30 kredi. Institucionit mund të certifikojë deri në 100 kandidatë në vit.
3. **Kuzhinier** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli IV sipas KKK-së, me gjithsej 25 kredi. Institucioni mund të certifikojë deri në 50 kandidatë në vit.
4. **Automekanik** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 21 kredi. Mund të certifikohen 10 kandidatë në muaj deri ne 120 kandidatë në vit.
5. **Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 15 kredi. Mund të certifikohen 10 kandidatë në muaj deri ne 120 kandidatë në vit.
6. **Instalues Elektrik** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 27 kredi. Mund të certifikohen 10 kandidatë në muaj deri ne 120 kandidatë në vit.
7. **Picamen** – Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 17 kredi. Institucioni mund të certifikojë deri në 50 kandidatë në vit.

A R S Y E T I M I

Instituti Profesional ATC SH.P.K. ka paraqitur aplikacionet dhe dokumentacionin për akreditimin e zbatimit të procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak për gjashtë kualifikime profesionale: Bërës ëmbëlsirash, **Kuzhinier, Automekanik, Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Instalues Elektrik, dhe Picamen.**

Vlerësimi është realizuar në bazë të dokumentacionit të paraqitur, dëshmive institucionale dhe profesionale, si dhe gjetjeve të evidentuara gjatë procesit të vlerësimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Instituti Profesional ATC SH.P.K. ka përcaktuar strukturën organizative, përgjegjësitë menaxheriale, koordinatorin për sigurimin e cilësisë dhe personat përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të NjMP-së.

Institucioni ka paraqitur dokumentacion për planifikimin financiar, planin e biznesit, zhvillimin institucional dhe burimet e nevojshme për zbatimin e procesit. Për kualifikimet Bërës ëmbëlsirash, Kuzhinier dhe Picamen janë paraqitur gjithashtu dëshmi për shfrytëzimin e objektit, hapësirat, pajisjet, kushtet infrastrukturore dhe llogaritjen e kostos së procesit të NjMP-së.

Dokumentacioni krijon bazë për qëndrueshmërinë institucionale dhe financiare të procesit. Megjithatë, meqenëse NjMP-ja ende nuk ka filluar në praktikë, institucioni duhet të vazhdojë dokumentimin e menaxhimit financiar, përdorimit të resurseve dhe transparencës së kostove ndaj kandidatëve.

Instituti Profesional ATC SH.P.K. ka paraqitur dokumentacion për personelin e angazhuar në mentorim, vlerësim dhe certifikim për kualifikimet e përfshira në aplikim.

Për kualifikimet Bërës ëmbëlsirash dhe Kuzhinier janë paraqitur dëshmi për personelin profesional të angazhuar në procesin e NjMP-së. Për kualifikimin Picamen janë paraqitur të dhëna për mentoren, vlerësuesin e brendshëm, instruktorin/vlerësuesin e brendshëm dhe vlerësuesin e jashtëm. Sipas dëshmive të ofruara nga AKK, institucioni ka të përfshirë vlerësues të jashtëm të certifikuar për profilet Kuzhinier/Picamen/Ndihmës Kuzhinier.

Për kualifikimet Automekanik dhe Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se nuk janë paraqitur dëshmi të plota për angazhimin e së paku dy vlerësuesve të jashtëm. Po ashtu, për personelin e angazhuar në profilet përkatëse është paraqitur informacioni se është në pritje të trajnimit për NjMP nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Kapaciteti profesional duhet të vlerësohet jo vetëm në bazë të numrit të personave të angazhuar, por edhe në raport me përvojën, kompetencat, trajnimet dhe ngarkesën reale të stafit. Duke qenë se një pjesë e personelit angazhohet në disa kualifikime, trajnime të rregullta dhe detyra të tjera profesionale, institucioni duhet të planifikojë në mënyrë të qartë mentorimin dhe vlerësimin.

Rekomandohet që të sigurohet angazhimi i vlerësuesve të jashtëm sipas kërkesave përkatëse, të përfundojnë trajnimet e nevojshme për NjMP dhe të dokumentohen kompetencat profesionale për secilin kualifikim.

Instituti Profesional ATC SH.P.K. ka paraqitur dokumentacion që përcakton politikat dhe mekanizmat për menaxhimin e cilësisë së vlerësimit në procesin e NjMP-së për të gjashtë kualifikimet.

Dokumentet trajtojnë sigurimin e cilësisë së brendshme, verifikimin e vlerësimit, përdorimin e instrumenteve të standardizuara dhe ruajtjen e evidencave të vlerësimit.

Kriteri vlerësohet se plotësohet kryesisht, sepse politikat dhe procedurat e paraqitura krijojnë bazë për një proces të drejtë, transparent dhe të dokumentuar, por kërkohen dëshmi shtesë për zbatimin praktik të tyre.

Gjatë zbatimit të NjMP-së duhet të dokumentohen shqyrtimi i portofolios, përdorimi i kritereve të vlerësimit, verifikimi i rezultateve, paanshmëria e panelit, vendimmarrja dhe ruajtja e evidencave për secilin kandidat.

Instituti Profesional ATC SH.P.K. ka zhvilluar procedura për certifikimin në kuadër të procesit të NjMP-së, të cilat përcaktojnë mënyrën e marrjes së vendimit për certifikim, përgjegjësitë e panelit vlerësues, dokumentimin e rezultateve dhe procedurat për lëshimin e certifikatave.

Dokumentacioni përshkruan kriteret për certifikim të plotë ose të pjesshëm modular, në përputhje me rezultatet e të nxënit të arritura gjatë vlerësimit.

Gjithashtu, institucioni ka paraqitur dokumentacion për harmonizimin e modeleve të certifikatave me formatin e përdorur në procesin e rregullt të certifikimit, si dhe procedura për ruajtjen e evidencave, regjistrimin e kandidatëve të certifikuar dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.

Gjatë zbatimit të NjMP-së duhet të sigurohet që çdo vendim për certifikim të mbështetet në rezultate të dokumentuara të vlerësimit dhe që evidencat të ruhen në përputhje me kërkesat e AKK-së.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit për kualifikimet: **Kuzhinier, Automekanik, Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Instalues Elektrik, dhe Picamen.** Vizitës së realizuar realizuar me datën 12.06.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 31.07.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës: 07.10.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese. AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Instituti "ATC",
- Arkivit të AKK.